



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1618/1 të datës 15.03.2023, kundër subjektit juridik „-----“, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka kompetencë për veprim në rastin në fjalë, ndërsa rasti të dorëzohet për verim kompetent në Ministrinë e punëve të brendshme të RMV-së.

Lënda me numër 12-1618/1 të datës 15.03.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 15.03.2023, është dorëzuar denoncim kundër një subjekti juridik „-----“ dhe është formuar lënda me numër 12-1618/1 të datës 15.03.2023.

Në denoncim, parashtruesi thekson se në personin juridik të përmendur, ortakët e shumicës ishin dy persona, të cilët zotëronin secili 45,3% të aksioneve, ndërsa ai së bashku me disa persona të tjerë ishin ortakë në pakicë dhe kishin në pronësi të përbashkët pjesën tjetër të aksioneve në shoqëri.

Parashtruesi vë në dukje procedimet gjyqësore që dy ortakët mazhoritar kanë zhvilluar ndaj bashkëshorteve të tyre, për shkak të pasurisë së Çerdhes, qëllimi i të cilave ishte fitimi i parregullt i një pjese më të madhe të pasurisë së subjektit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se në rastin konkret, bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent, por janë pretendime për një çështje që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, d.m.th. një departament kompetent në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: K.Z

Miratoi: S.P.D

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska**

